



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 316/15 prot.

Datë 01.04.2026

V E N D I M
Nr. 454/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.04.2026 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 364/2026, datë 09.03.2026 për procedurën e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje kuadër me një operator, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi”, me REF-74336-01-22-2026 me objekt: “Blerje Materiale mjekimi kirurgjikale, për 12 muaj”, me fond limit 19 165 372 (nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH ose 198,728.45 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e tetë pikë dyzet e pesë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a..

Ankimues:

Operatori ekonomik “SoLed” SHPK me NIPT M42026032D dhe adresë: Kompleksi Lake View, Rruga Kristo Luarasi, Godina B, Kati 4, Hytja B03, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 09.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 364/2026, të korrigjuar me vendimin nr.407/2026 datë 18.03.2026, ku vendosi:

“[....]”

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës e paraqitur nga operatori ekonomik “SoLed” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje kuadër me një operator, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi”, me REF-74336-01-22-2026 me objekt: “Blerje Materiale mjekimi kirurgjikale, për 12 muaj”, me fond limit 19 165 372 (nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH ose 198,728.45 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e tetë pikë dyzet e pesë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “SoLed” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje kuadër me një operator, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi”, me REF-74336-01-22-2026 me objekt: “Blerje Materiale mjekimi kirurgjikale, për 12 muaj”, me fond limit 19 165 372 (nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH ose 198,728.45 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e tetë pikë dyzet e pesë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet

e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve

4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi*
5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SoLed” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit*
7. *Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. [...]”

I.2. Me shkresën nr. 323/15 prot., datë 30.03.2026 me objekt “Mbi zbatimin e Vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik me nr.364/2026, dhe nr.407/2026 për procedurën me objekt “Blerje Materiale mjekimi kirurgjikale, për 12 muaj” me nr. REF-74336-01-22-2026”, protokolluar me tonën nr. 316/12 prot., datë 01.04.2026, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a njofton se ka zbatuar vendimin Nr.364/2026, datë 09.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, të korrigjuar me vendimin nr.407/2026 datë 18.03.2026, duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 323/15 prot., datë 30.03.2026 me objekt “Mbi zbatimin e Vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik me nr.364/2026, dhe nr.407/2026 për procedurën me objekt “Blerje Materiale mjekimi kirurgjikale, për 12 muaj” me nr. REF-74336-01-22-2026”, protokolluar me tonën nr. 316/12 prot., datë 01.04.2026, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a njofton se ka zbatuar vendimin Nr.364/2026, datë 09.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, të korrigjuar me vendimin nr.407/2026 datë 18.03.2026, duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se shtojca është publikuar në SPE.

Nga verifikimet në shtojcën e dërguar nga autoriteti kontraktor dhe publikuar në SPE, konstatohet se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e KPP Nr. 364/2026, datë 09.03.2026, të korrigjuar me vendimin nr.407/2026 datë 18.03.2026.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a e ka zbatuar vendimin Nr. 364/2026, datë 09.03.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, të korrigjuar me vendimin nr.407/2026 datë 18.03.2026, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje kuadër me një operator, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi”, me REF-74336-01-22-2026 me objekt: “Blerje Materiale mjekimi kirurgjikale, për 12 muaj”, me fond limit 19 165 372 (nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH ose 198,728.45 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e tetë pikë dyzet e pesë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 23.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

